



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 21 Qershor 2023

Nr: 667

Ora: 12:00

V E N D I M

P Ë R

**ZGJATJEN E AFATIT TË DENONCIMEVE NR. 328 ID, 330 ID, 331 ID, 336 ID, 346 ID DHE 360 ID
PËR SHKELJE ADMINISTRATIVE PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË
DATËS 14 MAJ 2023**

Në mbështetje të neneve 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f”, dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenit 7, pika 3, e vendimit nr. 9, datë 9.4.2021, “Për procedurat e funksionimit dhe mirëmbajtjes së portalit, procedurat dhe afatet e hetimit administrativ të denoncimeve dhe vendimin që merret në përfundim të tyre”, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

K O N S T A T O J :

Neni 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar përcakton kompetencat që ushtron Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve. Referuar nenit 7, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010, “Për kundravajtjet administrative”, kompetenca për konstatimin e kundërvajtjes, me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe, i takon organit administrativ, përgjegjës për zbatimin e ligjit të posaçëm, titullarit të organit administrativ, që merret me zbatimin e ligjit, në rastet kur ligji nuk shprehet për kompetencën për shqyrtimin e kundërvajtjes dhe nxjerrjen e vendimit përkatës. Bazuar në përcaktimet e nenit 7, të vendimit nr. 9, datë 9.4.2021, “Për procedurat e funksionimit dhe mirëmbajtjes së portalit, procedurat dhe afatet e hetimit administrativ të denoncimeve dhe vendimin që merret në përfundim të tyre” të Komisionit Rregullator, në

Komisionin Qendror të Zgjedhjeve:

-Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve fillon procedurën administrative dhe hetimin administrativ kryesisht me depozitimin e denoncimit në Portalin e Denoncimeve ose kur ajo mbërrin drejtpërdrejtë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

-Afati që ka Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për shqyrtimin administrativ të denoncimit është jo më i gjatë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga paraqitja e tij

-Afati i parashikuar në pikën 2, të këtij neni mund të zgjatet me vendim me shkrim të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, kur çështja është komplekse ose është e nevojshme kryerja e hetimeve administrative shtesë.

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në datën 18.4.2023, është administruar shkresa me nr. 3915 prot., nga z. Flamur Noka, Deputet i Kuvendit të Shqipërisë, i regjistruar me nr. 328 ID, me lëndë *“Përdorimi i burimeve publike”*, me objekt denoncimi *“Në media është publikuar foto e Kryetarit të Bashkisë Cërrik dhe z. Damian Gjikhuri në fshatin Shalës duke promovuar përdorimin e burimeve publike në prag të fushatës, veprim ky në kundërshtim me dispozitat ligjore”*.

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në datën 18.4.2023, është administruar shkresa me nr. 3914 prot., nga z. Flamur Noka, Deputet i Kuvendit të Shqipërisë, i regjistruar me nr. 330 ID, me lëndë *“Përdorimi i burimeve publike”*, me objekt denoncimi *“Në rrjetin social Facebook Bashkia Lezhë ka promovuar shpërndarjen e ndihmave ushqimore tek banorët nga personat me veshje të unifomave të Policisë, veprim ky në kundërshtim me dispozitat ligjore”*.

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në datën 18.4.2023, është administruar shkresa me nr. 3918 prot., nga z. Flamur Noka, Deputet i Kuvendit të Shqipërisë, i regjistruar me nr. 331 ID, me lëndë: *“Përdorimi i burimeve publike”*, me objekt denoncimi *“Në media është publikuar denoncimi i kryer nga Ylli Manjani për formularët e shpërndarë nga administrata shtetërore për punëmarrësit të cilët duhet t'i plotësojnë ato me qëllim votimi, veprim ky në kundërshtim me dispozitat ligjore të Kodit Zgjedhor, vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator dhe urdhërit nr. 46, datë 22.01.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve”*.

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në datën 21.4.2023, nëpërmjet ndërfaqes, është administruar shkresa me nr. 1114 ID , nga zj. Albana Vokshi, Deputet i Kuvendit të Shqipërisë dhe z. Ivi Kaso i regjistruar me nr. 346 ID dhe 360 ID me lëndë *“Përdorimi i burimeve publike”*, me objekt denoncimi *“z.Safet Gjici ka promovuar ne rrjetin e tij social Facebook punime te kryera nga Drejtoria e Rrugeve Rurale per rehabilitimin e rrugeve, takime me stafin dhe nxenesit e gjimnazit Havzi Nela, takime me stafin e kopshteve dhe te çerdheve”*.

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në datën 19.4.2023, është administruar shkresa me nr. 3946 prot., nga Organizata “Qendresa Qytetare”, i regjistruar me nr. 336 me lëndë

Data: 21 Qershor 2023

Nr: 667

Ora: 12:00



“Për zgjatjen e afatit të hetimit administrativ për denoncimet nr. 328, 330, 331, 336, 346, 360 ID.”

“Përdorimi i burimeve publike”, me objekt denoncimi “Në ambientet e jashtme të shkollës 9-vjeçare, Lusën, Ujmisht, është zhvilluar një takim mes kandidatit të Partisë Socialiste për Bashkinë e Kukësit, njëherazi dhe kryetar aktual i kësaj Bashkie, Z. Safet Gjici dhe banorëve të fshatit. Siç rezulton nga pamjet filmike, Z. Gjici ka qenë i shoqëruar nga Znj. Dallëndyshe Bici, Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës. Në ndërfaqen e raportimeve, nuk rezulton që aktiviteti në fjalë të jetë raportuar nga Bashkia e Kukësit. Po ashtu, aktiviteti nuk rezulton të jetë raportuar as nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës”.

Edhe pse ka përfunduar afati 60 (gjashtëdhjetë) ditor i shqyrtimit të këtij denoncimi, hetimi administrativ është ende i papërfunduar, për shkak të kompleksitetit të çështjes objekt shqyrtimi.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja “dh”, “f”, dhe “n” e pika 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenit 7, pika 3, e vendimit nr. 9, datë 9.4.2021, “Për procedurat e funksionimit dhe mirëmbajtjes së portalit, procedurat dhe afatet e hetimit administrativ të denoncimeve dhe vendimin që merret në përfundim të tyre” të Komisionit Rregullator, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

V E N D O S:

1. Zgjatjen e afatit të shqyrtimit administrativ të denoncimit nr. 328 ID, 330 ID, 331 ID, 336 ID, 346 ID dhe 360 ID.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet postës elektronike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Ilirjan CELIBASHI